




AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS
AGENCIJA ZA STATISTIKE KOSOVA
KOSOVO AGENCY OF STATISTICS



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria e Kosovës - Vlada Kosova - Government of Kosovo
Zyra e Kryeministrit - Ured Premijera
Office of the Prime Minister

VLERËSIM Popullsia e Kosovës 2012



Prishtinë,
Prill 2013

Botuesi: Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK)

Data e botimit: Prill 2013

Riprodhimi autorizohet nëse tregohet burimi.

E shtypur nga: K.G.T, Prishtinë, Kosovë

Informata të shumta janë në dispozicion në internet,

ku mund të qaseni përmes ueb-faqes së ASK-së në internet: <http://esk.rks-gov.net/>

Vlerësim
Popullsia e Kosovës
2012

Prishtinë,
Prill 2013

Parathenje

Me këtë Publikim ASK ka për qëllim që të sigurojë një vlerësim të saktë statistikor të popullsisë, i cili është i nevojshëm, praktikë dhe standard, që kërkohet të bëhet çdo vit nga institucionet zyrtare të statistikave të një vendi.

Kjo për faktin se në periudhën ndërmjet dy regjistrimeve (dhjetëvjeçare) ndodhin ndryshime të theksuara në popullsinë e një vendi, komune a vendbanimi.

Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) çdo vit do të vazhdojë të bëjë vlerësimin e numrit të popullsisë në nivel vendi dhe komunave që njëherit siguron serinë kohore të treguesve demografikë mbi ndryshimet në nivel territorial.

Të dhënat vjetore statistikore mbi popullsinë (demografinë) janë themelore për studimin dhe përcaktimin e një game të gjerë analizash. Sidomos lidhja dhe rëndësia e veçantë e tyre me çështjet sociale dhe ekonomike në nivele të caktuara komunale, kombëtare dhe rajonale.

Statistikat mbi popullsinë janë një emërues dhe tregues i rëndësishëm i vendimmarrësve, analistëve, hulumtuesve dhe shfrytëzuesve të ndryshëm të të dhënave.

Të dhënat mbi popullsinë përbëjnë komponentin thelbësor për vlerësimet e llogarive kombëtare, punësimit dhe çështjeve të tjera socio-ekonomike.

Prandaj, për të gjithë shfrytëzuesit e të dhënave, këto janë të dhënat e fundit zyrtare, të vlerësuara për numrin e popullsisë së Kosovës në nivel të komunave për vitin 2012.



A handwritten signature in blue ink, appearing to read 'Z. Isa Krasniqi'.

Kryeshefi i Agjencisë së Statistikave të Kosovës

Z. Isa Krasniqi

Përmbajtja

Faqe

- H y r j e -	6
Për shfrytëzuesit e të dhënave	6
Baza mbi vlerësimin e popullsisë	6
Vështrimi metodologjik	6
Burimet e të dhënave	7
KAPITULLI I	8
Popullsia bazë	8
KAPITULLI II	9
Shtimi natyror (01 janar - 31 dhjetor 2012)	9

- H y r j e -

Për shfrytëzuesit e të dhënave

Raporti përfshinë ndryshimet e numrit të popullsisë që kanë ndodhur gjatë periudhës 01 janar deri më 31 dhjetor 2012 në territorin e Kosovës.

Baza mbi vlerësimin e popullsisë

Në përgatitjen e këtij Vlerësimi, ASK-ja ka aplikuar metodat e praktikuara mbi vlerësimin e popullsisë, që bëhen nga institucionet statistikore, çdo vit, duke shfrytëzuar burimet e ndryshme.

Bazë e të dhënave është marrë numri i popullsisë i vlerësuar në fund të vitit 2011¹.

Vështrimi metodologjik

Për ta vlerësuar numrin e popullsisë rezidente në nivel kombëtar, popullsia është e ndikuar nga nataliteti, mortaliteti dhe migrimi ndërkombëtar (NMMN).

Vlerësimi i popullsisë = popullsia bazë + nataliteti – mortaliteti ± migrimi ndërkombëtar.

Në nivel komune, popullsia rezidente është e ndikuar edhe nga një komponent shtesë i ndryshimit të popullsisë: migrimit të brendshëm (NMMB).

Vlerësimi i popullsisë = popullsia bazë + nataliteti – mortaliteti ± migrimi i jashtëm/ brendshëm.

Të dhënat e vlerësuara përfundimtare mbi numrin e popullsisë në nivel të komunave janë llogaritur sipas procedurave të mëposhtme:

$$P_n + (N-M)+(I-E)$$

P_n -numri i banorëve të përlllogaritur për vitin e dhënë

N -numri i lindjeve të gjalla (Nataliteti), 01 janar-31 dhjetor 2012

M -numri i vdekjeve (Mortaliteti), 01 janar-31 dhjetor 2012

I - imigrimet, 01 janar-31 dhjetor 2012

E –emigrimet, 01 janar-31 dhjetor 2012

¹ Vlerësim: Popullsia e Kosovës 2011

Burimet e të dhënave

Janë shfrytëzuar burime të ndryshme statistikore, si: bazat nga regjistrimet e popullsisë, bazat e shënimeve nga regjistrat e ndryshëm, burimet e tjera administrative, anketat, raportet dhe hulumtimet tjera.

Këto të dhëna janë analizuar sipas metodave statistikore, duke shërbyer si instrumente dhe shënime të rëndësishme statistikore për ta bërë vlerësimin e numrit të popullsisë në nivel vendi dhe në nivel të komunave.

Si baza reference në këtë Vlerësim janë shfrytëzuar këto burime:

- *Të dhënat nga Regjistrimi i Popullsisë: burimi i informacionit, regjistrimi 2011, ASK*
- *Të dhënat nga komunat: burimi i informacionit, ueb faqet dhe dokumenteve tjera zyrtare të komunave*
- *Të dhënat nga UNHCR: iu referohen të dhënave të fundit nga baza e statistikave nga kjo organizatë*
- *Të dhënat e tjera: iu referohen publikimeve të ndryshme të organizatave, institucioneve apo grupeve të caktuara*

KAPITULLI I

Popullsia bazë

Sipas vlerësimit të vitit 2011 numri i popullsisë në Kosovë pas regjistrimit të muajit prill 2011 është rritur për 20.705 banorë brenda nëntë (9) muajve. Bilanci i migrimeve brenda kësaj periudhe ishte -2.081 banorë. Kosova në fund të vitit 2011 numëronte gjithsej 1.798.645 banorë.

Tabela 1. Të dhënat përfundimtare të vlerësuara për vitin 2011 sipas komunave

Komunat	Të dhënat nga:				Gjithsej popullsia e vlerësuar (31 dhjetor 2011)
	Regjistrimi i Popullsisë 2011	Shtimi natyror (01/04-31/12/2011)	Bilanci i migrimeve		
			Të jashtme (01/04-31/12/2011)	Të brendshme (01/04-31/12/2011)	
Deçan	40,019	449	-47	-29	40,392
Gjakovë	94,556	992	-111	-74	95,363
Glogoc	58,531	816	-68	-119	59,160
Gjilan	90,178	831	-105	-41	90,863
Dragash	33,997	427	-40	-76	34,308
Istog	39,289	409	-46	75	39,727
Kaçanik	33,409	378	-39	-84	33,664
Klinë	38,496	620	-45	-24	39,047
Fushë Kosovë	34,827	450	-41	497	35,733
Kamenicë	36,085	199	-42	-261	35,981
Mitrovicë	84,235	887	-98	-75	84,949
Leposaviq	13,773	-38	-16	-7	13,712
Lipjan	57,605	787	-67	-33	58,292
Novobërdë	6,729	15	-8	60	6,796
Obiliq	21,549	249	-25	-4	21,769
Rahovec	56,208	862	-66	-72	56,932
Pejë	96,450	1,031	-113	-8	97,360
Podujevë	88,499	1,015	-103	-534	88,877
Prishtinë	198,897	2,317	-233	823	201,804
Prizren	177,781	2,087	-208	209	179,869
Skënderaj	50,858	718	-59	-262	51,255
Shtime	27,324	369	-32	-16	27,645
Shtërpçë	6,949	28	-8	-27	6,942
Suharekë	59,722	951	-70	-54	60,549
Ferizaj	108,610	1,275	-127	141	109,899
Viti	46,987	539	-55	-63	47,408
Vushtri	69,870	800	-82	-93	70,495
Zubin Potok	6,616	-6	-8	-3	6,599
Zveçan	7,481	-23	-9	-6	7,443
Malishevë	54,613	1,031	-64	-110	55,470
Junik	6,084	59	-7	15	6,151
Mamushë	5,507	82	-6	1	5,584
Hani i Elezit	9,403	120	-11	2	9,514
Graçanicë	10,675	-4	-12	212	10,871
Ranillug	3,866	-12	-5	4	3,853
Partesh	1,787	-2	-2	1	1,784
Kllokot	2,556	-2	-3	34	2,585
Gjithsej	1,780,021	20,705	-2,081	0	1,798,645

KAPITULLI II

Shtimi natyror (01 janar - 31 dhjetor 2012)

Gjatë vitit 2012 popullsia e Kosovës, bazuar në të dhënat vitale (*lindjet dhe vdekjet*) për periudhën në fjalë, kishte shtimin natyror prej 20.363 banorëve.

Migrimet (01 janar - 31 dhjetor 2012)

Saldoja e migrimit bazuar në të dhënat e disponueshme te ASK për vitin 2012 ishte -3.402 banorë.

Shtimi i popullsisë (01 janar - 31 dhjetor 2012), rritja e përgjithshme e popullsisë së Kosovës gjatë vitit 2012 ishte 16.961 banorë.

Tabela 2. Të dhënat përfundimtare të vlerësuara për vitin 2012 sipas komunave

Nr.	Komunat	Popullsia e vlerësuar (31 dhjetor 2011)	Shtimi natyror (01.01-31.12/2012)	Bilanci i migrimeve (01.01-31.12/2012)	Rritja gjithsej për vitin 2012	Gjithsej popullsia e vlerësuar (31 dhjetor 2012)
1	Deçan	40,392	346	-124	222	40,614
2	Gjakovë	95,363	977	-269	708	96,071
3	Glllogoc	59,160	858	-266	592	59,752
4	Gjilan	90,863	790	-240	550	91,413
5	Dragash	34,308	290	-188	102	34,410
6	Istog	39,727	396	27	423	40,150
7	Kaçanik	33,664	407	-178	229	33,893
8	Klinë	39,047	522	-102	420	39,467
9	Fushë Kosovë	35,733	527	637	1,164	36,897
10	Kamenicë	35,981	125	-395	-270	35,711
11	Mitrovicë	72,623	785	-248	537	73,160
12	Mitrovica e V.	12,326	0	-23	-23	12,303
13	Leposaviq	13,712	4	-34	-30	13,682
14	Lipjan	58,292	800	-183	617	58,909
15	Novobërdë	6,796	21	74	95	6,891
16	Obiliq	21,769	285	-43	242	22,011
17	Rahovec	56,932	734	-215	519	57,451
18	Pejë	97,360	1,063	-186	877	98,237
19	Podujevë	88,877	1,245	-937	308	89,185
20	Prishtinë	201,804	2,520	809	3,329	205,133
21	Prizren	179,869	1,933	-46	1,887	181,756
22	Skenderaj	51,255	697	-461	236	51,491
23	Shtime	27,645	361	-66	295	27,940
24	Shtërpcë	6,942	64	-40	24	6,966
25	Suharekë	60,549	824	-183	641	61,190
26	Ferizaj	109,899	1,307	-65	1,242	111,141
27	Viti	47,408	407	-179	228	47,636
28	Vushtrri	70,495	828	-281	547	71,042
29	Zubin Potok	6,599	10	-17	-7	6,592
30	Zveçan	7,443	1	-23	-22	7,421
31	Malishevë	55,470	1,010	-291	719	56,189
32	Junik	6,151	54	7	61	6,212
33	Mamushë	5,584	120	-9	111	5,695
34	Hani i Elezit	9,514	67	-14	53	9,567
35	Graçanicë	10,871	20	306	326	11,197
36	Ranillug	3,853	-10	-1	-11	3,842
37	Partesh	1,784	-17	-1	-18	1,766
38	Kllokot	2,585	-8	46	38	2,623
	Gjithsej	1,798,645	20,363	-3,402	16,961	1,815,606